

ALBANSKA /SHQIP

VOTO MË 19 SHTATQË DREJT NJË QEVERIE MË TË GJELBËR

Nëse mund të zgjedhësh se si do të dukej bota, ndoshta kjo do të ishte më e gjelbër. Kjo ndoshta do të ishte më moderne, më njerëzore dhe më miqësore ndaj mjedisit. Ti ndoshta do të zgjedhësh lirinë e individit, rritje të qëndrueshme dhe siguri sociale. Ti mund të zgjedhësh. Në shtator janë zgjedhjet parlamentare. Partia e mjedisit (Miljöpartiet) dëshiron të bëjë një ndryshim të gjelbër, të gjithë shoqërisë. Kjo është gjëja më e mirë për Suedinë. Zgjedhja jote mund të kontribuoj një ndikim të madh të gjelbër në qeverinë e re.

Zgjedh një politikë me vizione – voto gjelbër më 19 shtator!

miljöpartiet de gröna



MIQTË E KLIMËS

Shoqëria ka nevojë të modernizohet. Për të përballuar sfidat e të ardhmes, duhet një politikë e re. Suedia është përballë provave të mëdha, që ka të bëjë me klimën, ekonominë dhe punën. Partia e mjedisit ka një politikë për këtë. Një ndryshim i gjelbër përballon klimën, e bën shoqërinë më moderne jep punë dhe mirëqenie. Ky jep një ekologji dhe ekonomi të mirë.

Suedia duhet të merr përgjegjësi për klimën. Vendet të cilat guxojnë të jenë të para, do të prijnë në botë. Ato që mbeten të fundit, do të kenë një ekonomi dhe zhvillim të pashpresë. Vendi ynë mund të prijë e para në punën për klimën. Partia e mjedisit dëshiron të bëjë investime të mëdha në infrastrukturë, teknikë dhe energji. Investimet e gjelbra japin punë dhe rritje të qëndrueshme, njëkohësisht ndalohej ndryshimi i klimës.

Duhet të jetë e leverdishme të jetosh miqësisht me klimën. Çdo njeri lë gjurmë. Çdo njeri është i rëndësishëm, dhe ka nevojë të bëjë më shumë për klimën. Një mënyrë e jetesës e qëndrueshme, nuk duhet domosdosmërisht të jetë një sakrificë. Tashmë ka zgjidhje. Ajo çka lypset është një politikë që ajo të realizohet. Partia e mjedisit dëshiron të ndërtoj një Suedi ku zgjedhjet miqësore të klimës janë të thjeshta dhe më të lirata.

GJELBËR JEP PUNË

Punët e të ardhmes janë punë të gjelbra. Shumë punë të reja do të kenë shenjë të klimës. Investimet në hekurudha, tramvaje dhe korsit për biçikleta, japin punë. Investimet në energjinë e erës, energjinë e dallgëve, diellit dhe përsosje me efikasitet më të madh, jep punë. Ambicijet e larta për klimën është përgjigja, në ndryshimet e klimës, papunësisë dhe e koniunkturës së ulët.

Sipërmarrësit janë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e shoqërisë. Idetë e reja, angazhimin për mjedisin dhe përgjegjësi sociale, shpesh përhapen nga sipërmarrësit. Këtë dëshiroj të nxis Partia e mjedisit. Ka nevojë të bëhet më e thjeshtë, më e sigurt dhe më me pak rreziqe të jesh ndërmarrës. Atëherë më shumë njerëz guxojnë t'i realizojnë vizionet e tyre. Atëherë mund të rriten ndërmarrjet e vogla. Nga kjo përfiton Suedia.

Është koha të lëmë pas shoqërinë, blej dhe hedh poshtë. Partia e mjedisit dëshiron të inkurajoj për një konsumim të qëndrueshëm, duke e ulur TVSh-n për shërbimet. Duhet të jetë më lirë të riparosh se sa të blesh një gjë të re. Atëherë numri i vendeve të punës në sektorin e shërbimeve rritet. Një ndryshim i gjelbër është i shkathët dhe i leverdishëm, por kërkohet që dikush të guxoj të mendoj ndryshe. Partia e mjedisit guxon.

SIGURIA ËSHTË LIRI

Që të punojnë njerëzit është një parakusht i mirëqenies. Por, një mirëqenie që nuk i ndihmon ata të cilët nuk kanë punë ose që nuk mund të punojnë, nuk ia vlen të quhet mirëqenie. Ne njerëzit kemi një përgjegjësi për njëri tjetrin. Siguria e shtuar zvogëlon të qëndruarit mënjane dhe e bën gjithë Suedinë më të fort. Sistemi i shkatërruar i sigurisë ka nevojë të riparohet.

Përderisa njerëzit janë të sëmurë, ata duhet të marrin kompensim në rast sëmundje. Të gjithë ata që nuk kanë punë, duhet të përfshihen nga sigurimi për papunësinë. Shoqëria duhet të ofroj atë ndihmë për të cilën individit ka nevojë, p.sh. rehabilitim ose shkollim. Njerëzit nuk janë më të shëndetshëm, duke u varfëruar. Nuk ka më shumë vende të punës, nëse njerëzit varfërohen.

Partia e mjedisit dëshiron të krijoj një shoqëri ku njerëzve ju lejohet të jenë të ndryshëm. Njerëzit të cilët janë ballafaquar me mossukses, duhet t'u ofrohet një shans i vërtetë të rikthehet. Siguria është liri. Siguria bën që më shumë njerëz guxojnë t'i provojnë idetë e tyre. Për ide ka nevojë që shoqëria të zhvillohet dhe të bëhet më e mirë. Idetë e Partisë së mjedisit, domethënë më shumë barazi, me pak diskriminim dhe më njerëzi.

VOTA JOTE LLOGARITET

Problemet e sodit nuk mund të zgjidhen me zgjidhjet e së djeshmes. Me një ndryshim të gjelbër e shpëtojmë klimën, krijojmë më shumë vende të lira pune dhe ekonomi më të mirë. Partia e mjedisit është një fuqi që duhet llogaritur, dhe nëse bëhemi më shumë jemi edhe më të fortë.

Ti mund të bëhesh anëtar i Partisë së mjedisit duke paguar përmes sms. Dërgo sms: mpmmdl vvvvm-mddxxxx (viti, muaji, dita, katër shifrat e fundit të numrit personal) në 72456. Kostoja: 50 korona plus tarifa e trafikut.

Ne kemi nevojë për numrin tënd personal, për të ditur kush je ti. Dërgo me dëshirë një adresë të e-postës ashtu që ne lehtë të biem në kontakt me ty.

Ti mundesh, po ashtu, të bëhesh anëtar duke paguar me kartelë ose duke porositur një kartëpagesë. Për të paguar me kartelë ose të porositësh një kartëpagesë, hy në www.mp.se/blimedlem. Ti, po ashtu, mund të telefonosh 08-545 224 50.

Kontakto Partinë e mjedisit duke vizituar www.mp.se, ose duke telefonuar 020-94 20 00.